

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PROKURIMEVE

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot më datë **26 / 06 / 2024**, në **Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë**, nga Njësia e Prokurimit, e përcaktuar në urdhrin e prokurimit nr.6352 Prot., datë 21.06.2024 (N.U. 474 dt.21.06.2024) të titullarit të Autoritetit Kontraktor, në lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, për procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme:

Autoritetit kontraktor: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë

Lloji i procedurës: Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Objekti: “Blerje pajisje kancelarie për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë”

Kodi Përkatës Në Fjalorin E Përbashkët Të Prokurimit (CPV): MALLRA, Kodet CVP: “Letër printimi” – 30197630-1, “Letër fotokopjuese” – 30197643-5, “Zarfa” – 30199230-1, “Letër e vazhdueshme për printera kompjuteri” – 30199330-2, “Furnizime e zyrës” – 30192000-1, “Mjete ndihmëse për letrat” – 30194500-0, “Bllok shënimesh” - 22816100-4, “Stilolapsa me majë të rumbullakët” - 30192121-5, “Stilolapsa” - 30192124-6, “Lapsa” - 30192130-1, “Korrektues” - 30192160-0, “Produkte boje” – 30192110-5, “Heqes i kapseve te letrave” - 30197321-2, “Kompakt disqe (cd)” - 30234300-1, “Gërshërë” - 39241200-5, etj,

Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve) REF-11281-06-26-2024

Data e zhvillimit do të jetë **10.07.2024** , ora **11:00**. në adresën www.app.gov.al

Vlera e fondit limit: 1,689,127 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzetë e shtatë) leke pa TVSH.

Grupi i punës për përcaktimin e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike i ngritur me anë të urdhrin të brendshëm nga titullari i AK, Nr. 5124 prot., datë 17.05.2024 ka perlllogaritur vleren e fondit të nevojshëm për këtë objekt prokurimi, mbështetur në mesataren e ofertave të marra nga testimi i tregut.

Nga sa më sipër ka hartuar procesverbalin mbi vendosjen e fondit limit për procedurë me objekt **“Blerje pajisje kancelarie për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë”**

Është vendosur që procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj. me objekt: **“Blerje pajisje kancelarie për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë”**, të mos kryhet e ndarë në lote nisur nga natyra e mallrave që do të furnizohen. Ky mall duhet të ofrohet nga një operator ekonomik sipas kushteve dhe standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike pjesë e këtyre dokumentave.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76, si dhe bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: *“1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. 2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.”* si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, nenit 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar shtojcës 7 pika 1 e saj, ofertuesi duhet të deklarojë që përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/ kualifikimit. këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas shtojcës 8.

Argumentimi:

Përsa më sipër, referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *operatori ekonomik fitues (i kualifikuar në vënd të parë në SPE) duhet të paraqesi dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe*

dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo më vonë se 5 dite nga klasifikimi i bërë nga A.K.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

“Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës,”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 1, te nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat duhet të jenë të nënshkruara nga Blerësi dhe Shitësi.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 55, pika 4, b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat e leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015 (e vlefshme)ose ekuivalente e saj në fushën e menaxhimit të cilësisë;**

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në :

- **nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar);**
- **nenin 44, pika 1 dhe 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.**

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë kërkesat e cilësisë dhe demonstron aftësinë për të siguruar vazhdimisht produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e klientit. Certifikimi ISO 9001:2015 vërteton se një kompani që e posedon atë, ka përmbushur standardet e cilësisë sipas atyre ndërkombetare dhe lidhet drejtpërdrejt me mënyrën se si një kompani/operator ekonomik e zhvillon/përmirëson biznesin e tij në lidhje me përmbushjen e kërkesave të klientit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ditën e hapjes së ofertave ,në orën dhe vendin e caktuar në dokumentet e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion për disa nga mallrat objekt prokurimi përkatësisht me nr.rendor. **22, 23, 48, 57.**

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.

Shënim: Me qellim shqyrtimin e mostrave mbi plotesimin e specifikimeve teknike të kerkuara nga autoriteti kontraktor në DST, për artikullin nr.58 “Letër A4, 80 g/m2” mostra duhet të jetë e shoqëruar me **Skedën teknike** te certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku te jene te pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike te tij.

Argumentimi:

Kriteri i mesiperme është vendosur në përputhje me nenin 77 pika 4 e ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” dhe piken 6 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar).

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mallrat objekt prokurimi janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 5 dhe do të jenë te njëjta me mostrat e paraqitura në procedurë.

2.3.5 .Operatori ekonomik duhet te deklarojë që merr përsipër transportin mallit pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të përcaktuar

Argumentimi ligjor: Nenit 40, pika 6 dhe 8 , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kriteret e mesiperme sigurojnë AK-në se produktet objekt prokurimi, do të jenë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST-të dhe do të sigurojnë lëvrimin e mallit pranë autoritetit pa kosto shtesë.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesit i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Përsa më sipër, referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik fitues (i kualifikuar në vënd të parë në SPE) duhet të paraqesi dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo me vonë se 5 dite nga klasifikimi i bërë nga A.K.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Sasia dhe specifikimet: Sipas tabelës nr.1

Nr.	PËRSHKRIMI	Njësia	Sasia
	Kancelari		
1	Stilolapsa te thjeshte me kapak 1mm blu	Copë	500
2	Stilolaps cilesor me suste K15, Schneider blu/ekuivalent (të loguar)	Copë	100
3	Stilo lantu rapid, blu /ekuivalent	Copë	500
4	Laps plumbi me gomë	Copë	300
5	Gome (fshirës lapsi)	Copë	100
6	Kapëse aktesh 3	Kuti	500
7	Kapëse aktesh 5	Kuti	100
8	Zarf i bardhë 23 x 33 cm (të loguar)	Copë	10,000
9	Zarf i bardhë 23 x 11 cm (të loguar)	Copë	20,000
10	Zarf plastik me vrima me trashesi 90mic/ pako me 100 cope	Pako	300
11	Korrektor stilo 8 ml	Copë	50
12	Shirit ngjites transparent i hollë $\geq 18\text{mm} \times 36\text{m}$	Copë	50
13	Shirit ngjites transparent i gjerë $\geq 48\text{mm} \times 50\text{m}$	Copë	50
14	CD-R 800 Mb, 52x80 min, me kuti vetiake secila	Copë	100
15	Bllok shënimesh A4 min 200 flete me kapak te zi (të loguar)	Copë	75
16	Bllok shënimesh A5 min 200 flete me kapak te zi (të loguar)	Copë	75
17	Bllok postit 76x76 mm min 100 flete ngjyra te ndryshme	Copë	250
18	Bllok postit kub shumëngjyrësh 76x76 mm me min 400 flete	Copë	100
19	Axhendë 2024 format A4 (17.2x24, min 320 fq) kapak lekure (të loguar)	Copë	50

20	Axhendë 2025 format A4 (17.2x24, min 320 fq) kapak lekure (të loguar)	Copë	50
21	Gërsherë metalike 20-21 cm	Copë	30
22	Dosje me mekanizëm me kuti me permasa 28cm x 34cm x 8 cm	Copë	300
23	Dosje të thjeshta kartoni prespan trashesia e kartonit 450 gr me permase 25cm x 33cm	Copë	17,500
24	Dosje me llastik, ngjyre blu, prespan trashesia e kartonit 450 gr, 25x35cm	Copë	300
25	Dosje me buton 8 cm prespan trashesia e kartonit 450 gr	Copë	150
26	Dosje me buton 12 cm prespan trashesia e kartonit 450 gr	Copë	90
27	Dosje kuti Arkivi me permasa 40cmx27cmx18cm standart shteteror me veshje te perforcuar me kapak	Copë	100
28	Makinë kapëse 24/6	Copë	30
29	Tela makine kapëse 24/6 te jete material I fort inox per 25 flete	Kuti	300
30	Mbajtëse kancelarie me aksesore permasa min 14.5 cm x 11 cm x 10.5 cm me min 6 ndarje	Copë	20
31	Mbajtëse dokumentash horizontale metalike 3 kate	Copë	20
32	Binder clips 12 mm me min 12 cp/kuti	Kuti	300
33	Binder clips 24 mm me min 12 cp/kuti	Kuti/	300
34	Binder clips 32 mm me min 12 cp/kuti	Kuti	50
35	Binder clips 41 mm me min 12 cp/kuti	Kuti	50
36	Binder clips 51 mm me min 12 cp/kuti	Kuti/	50
37	Zgjatues me 5 vende, me filtër mbrojtës	Copë	20
38	Marker për tabelë me min 4 cp/kuti	Kuti	20
39	USB (16 GB), 3.2	Copë	50
40	USB (32 GB), 3.2	Copë	50
41	Vizore 40 cm	Copë	10
42	Evidenciator 4 ngjyra	Set	150
43	Tampon vule	Kuti	10
44	Bojë vule blu, min 30 ml jo toksike	Copë	30
45	Ndarese me 4 ngjyra per firma 50/15	kuti	2500
46	Kosh për zyrë (me rrjetë metalike)	Copë	15
47	Etiketa ngjitese tek dosjet	cope	350
48	Liber protokolli min 200 flete A4, i printuar nga te dyja anët, (me qepje, sipas formatit bashklidhur dhe të loguar)	cope	25
49	Liber magazine min 200 flete A5, i printuar nga te dyja anët (sipas formatit bashklidhur dhe të loguar)	cope	10
50	Liber arkive min 200 flete A3, i printuar nga te dyja anët (sipas formatit bashklidhur dhe të loguar)	cope	20
51	Liber dorezimi min 200 flete A4, i printuar nga te	cope	25

	dyja anët (sipas formatit bashklidhur dhe të loguar)		
52	Liber poste Min 200 flete A5, i printuar nga te dyja anët (sipas formatit bashklidhur dhe të loguar)	cope	20
53	Regjister personeli Min 250 flete A3, i printuar nga te dyja anët (sipas formatit bashklidhur dhe të loguar)	cope	1
54	Bllok flete-hyrje Min 30 fletë A5, me nga 3 kopje social fletë (sipas formatit bashklidhur)	cope	10
55	Bllok flete dalje Min 30 fletë A5, me nga 3 kopje social fletë (sipas formatit bashklidhur)	cope	50
56	Bexha te personalizuar plastike ku te vendosen te dhenat sipas modelit bashklidhur dhe e pajisur me Rrip vares. Shiriti vares, te jete material tekstil me fibra sintetike, gjatesi 80 cm, gjeresi 2 cm. • Te ketë nje kapse plastike femer-mashkull, e cila realizon bashkimin e shiritit me bexhën plastike, ana femer kapse eshte e fiksuar me shirit, ana mashkull e kapses eshte e fiksuar me nje shirit te njejt material i cili ne skajin tjeter ka nje kapse tip ganxhe e cila sherben per te mbajtur -bexhën plastike. Ne shirit eshte mbishkrimi Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, e cila realizohet me stampim me boje me ngjyre blu (boja te jete rezistente) Kjo te jete ne te dyja, anet e saj ku ne fillim e fund te shkrimit te jete stema e Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë • Shiriti vares te jete me ngjyre të kuqe.	cope	100
	Letër		
57	Letër A4 (210x297 mm), 80 g/m ² , Specifikimet për letrën A4 të bardhë Pesha: 80 g/m ² , (paketim 500 fije/rizme, kutia te permbaj 5 rizma), amballazhimi me mbeshtjellje kunder lageshtise dhe kuti me kapacitet 5 rizma, letra te mos bllokoje makinen fotokopjuese apo printerin dhe te mos leshoj pluhur. Lagështia në % 3.5 - 4.5 Bardhësia: ≥ 160 % pa lluster, Lëmueshmeria: 80 - 120 ml/min, Trashesia: të ketë trashësi brenda marzhit të përcaktuar nga tipi i letrës 80 GSM Shkelqimi 105-112%,	Rizma	1500
58	Letër A3, me permasa 297 x 420 mm, 80 g/m ² Specifikimet për letrën A3 të bardhë Pesha: 80 g/m ² , (paketim 500 fije/rizme, kutia te permbaj 5 rizma), amballazhimi me mbeshtjellje kunder lageshtise dhe kuti me kapacitet 5 rizma, letra te mos bllokoje makinen fotokopjuese apo printerin dhe te mos leshoj pluhur.	Rizma	100

	Lagështia në % 3.5 - 4.5 Bardhësia \geq 160 % pa lluster, Lëmueshmeria 80 - 120 ml/min, Trashësia të ketë trashësi brenda marzhit të përcaktuar nga Tipi i letrës 80 GSM Shkelqimi 101-112%,		
--	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--

***Shënim:** Për zërat ku specifikohet “të loguar” do të logohet gjithë sasia me logon e Institucionit “Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë”, bashkëlidhur DST.

Specifikimet teknike do të jenë sipas tabelës si dhe modeleve bashkëlidhur DST.

Argumentimi:

Specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi janë hartuar nga **Grupi i punës për përcaktimin e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike i ngritur me anë të urdhrorit të brendshëm nga titullari i AK, Nr. 5124 prot., datë 17.05.2024** bazuar në nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me pajisjet kompjuterike dhe aksesore duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për sa më sipër, specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala “**ose ekuivalente**” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 dymbëdhjetë muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

Afatet e lëvrimit: Do të jetë nga momenti i nënshkrimit të kontratës **brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike.**